



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:046604  
Datë: 20.08.2024  
Numri i dokumentit: 06068215

Ac.nr.2244/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nehat Idrizi, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I. D., nga fshati K..., Komuna e Podujevës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sylejman Klinaku, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Podujevës, Drejtoria Komunale e Arsimit, Podujevë, rruga Nuhi Gashi, p.nr, për kompensimin e pagave jubilarë dhe shpenzimeve të ushqimit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, C.nr.363/20, të datës 16.02.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 15.08.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit I. D., nga fshati K..., Komuna e Podujevës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil, C.nr.363/20, i datës 16.02.2022, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.363/2020, të datës 16.02.2022, në dispozitiv të saj, e ka aprovuar kërkespadinë e paditësit I. D., nga fshati K..., Komuna e Podujevës, si të bazuar. Si dhe, ka obliguar të paditurën Komuna e Podujevës, Drejtoria e Arsimit, që paditësit I. D., nga fshati K..., Komuna e Podujevës, t'ia kompensojë në emër të kompensimit të ushqimit ditor, për ditët e pranisë në punë- shujta për ... ditë pune, nga 2 euro, gjithsej shumë prej ... euro, dhe 75%, të një page bazë, në lartësi prej ... euro, e në shumë të përgjithshme prej ... euro, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej ... euro, të gjitha në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarrimit.

Kundër këtij aktgjykimi paditësi ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabua të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të merr vendim që ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthej në rigjykim, apo të njëjtin vendim ta ndryshojë duke e aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, si dhe shpenzimet e përpilimit të ankesës

Përgjigje në ankesë ka paraqitur e paditura, duke propozuar që ankesa e paditësit, të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi me datë ..., ka paraqitur padi për kompensimin e pagave jubilarë dhe kompensimin e shujtave- ushqimit. Me datë ..., e paditura ka paraqitur përgjigje në padi, duke e kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, si të pa bazuar. Me datë 17.01.2022, paditësi ka paraqitur parashtresë, me të cilën ka bërë precizimin e padisë së tij, sa i përket aspektit subjektiv të paditurës.

Gjykata e shkallës së parë, jashtë seancës gjyqësore, konform nenit 398, të LPK-së, e lidhur me nenin 152, të LPK-së, i cili përcakton se: po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore të jep aktgjykim, lidhur edhe me nenin 143 dhe 147, të njëjtit ligj, dhe se paditësi ka paraqitur prova mbi bazën e të cilave mund edhe të vendoset, ka marr aktgjykimin e atakuar, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, si të bazuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se nuk është kontestuese se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura për më shumë se 20 vite, përvojë punem, derisa është pensionuar sipas fuzisë ligjore pas mbushjes së moshës 65 vjecare, me datë ..., po ashtu, nuk është kontestuese se e paditura nuk i ka paguar paditësit pagesën e ushqimit ditor për ditët e pranisë në punë dhe pagën prej 75%, të pages bazë në emër të shpërblimit jubilar pasi që një e tillë nuk kontestohet nga palët, e që vërtetohet edhe me prova materiale në shkresa të lëndës.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, nenit 2, 35 par.7, nenit 90 par.4, të Ligjit të Punës, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës, e bazoi në nenin 449, 450, 452 dhe 453, par.1, të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i

përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, në të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194, të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, se paditesi ka themeluar mardhenie pune tek e paditura në SHFMU, “Aleksander Xhuvani”, në bazë të Kontrates së punës, numër ..., të datës ..., dhe se në bazë të vërtetimit nr..., të datës ..., i njëjti ka gjuhësej 475 (katerqind e shtatdhejtë e pesë) ditë pune, andaj edhe i takon kompensimi për ushqim, ashtu që në mbështetje të nenit 35, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e paditura duhet t’ia kompensoj paditësit shpenzimet e ushqimit ditor nga dy/2/ euro, në shumë të përgjithshme prej ... euro, si dhe për 75%, të një page bazë, në lartësi prej ... euro, e në shumë të përgjithshme prej ... euros. Andaj, gjykata kishte ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, kështu që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe pagës jubilarë, e detyroi të paditurën, si në dispozitivin e aktgjyqimit të atakuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit si në ankesë, se Gjykata në shkallë të parë, kë bërë shkelje esenciale të LPK-së, meqenëse vendimin e ka nxjerr pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor të çështjes, pasi dispozitat ligjore, neni 398, i LPK-së, e ka paraparë se Gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë, siç edhe ka vepruar në këtë rast, pasi për të, nuk ka qenë kontestuese se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, se me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet, kështu që janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e këtij lloj aktgjyqimi.

Po ashtu, nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore të paditësit se gjykata e shkallës së parë se gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, pasi me nenin 35, paragrafi 7, i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë - *Kontrata nr. 24 e dt. 18.04.2017/*, e ka paraparë në mënyrë shprehimore se *„të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është dy /2/ € për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore”*.

Pretendimet ankimore të paditësit se Gjykata në shkallë të parë, ka nxjerr vendimin më vonë dhe se të njëjtit i takojnë edhe ditë tjera shtesë për shujta, ushqim, pagë jubilarë dhe transport, edhe pas kësaj date, në tërësi janë të pa bazuara, pasi paditësi ka dal në pension me datë 21.05.2019, që vërtetohet nga provat në shkresa të lëndës, e që të njëjtit i ka pushuar marrëdhënien e punës sipas fuqisë ligjore, dhe se nuk ka të drejtë në realizimin e ketyre kërkesave pas kësaj date.

Gjithashtu, nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore sa i përket kamatës, pasi paditësi, në precizimin e bërë të kërkesëpadisë së tij, me datë 17.01.2022, nuk e ka cekur edhe vendosjen e kamatës, pasi Gjykata ka detyrim ligjor që të veproi sipas precizimit të kërkesës së fundit të bërë të paditësit, siç ka vepruar në rastin konkret, pasi po të vendoste edhe për kamatën, do të vendosej jashtë kërkesës se palas dhe do të ishte në kundërshtim me dispozitat ligjore, nenin 182.2, pika

o), të LPK-sa, qa e parasheh se shkelje esenciale është: *në qoftë se me aktgjykim është tejkualuar kërkesëpadia*, e të cilin qëndrim si të drejtë e aprovon edhe kjo Gjykatë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës, është marr në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, e në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e lartcekura, të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes, i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditësit, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2244/2022, me datë 15.08.2024

Kryetari i kolegjit- Gjyqtari  
Nehat Idrizi d.v

---